



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik


01Nr. 104/02- 1493/23
Kaçanik, 31.01.2023

Në bazë nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), të nenit 10 lidhur me nenin 13 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 (Gazeta Zyrtare Nr. 04.L-060 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/29 Qershor 2012), të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L -071 - për ndryshim plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 Për Mbeturina (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/1 shtator 2022), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të nenit 4 të Rregullores 01Nr. 07-60/01-17890/19 - Për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Kaçanikut, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, duke vendosur sipas Kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit 53-2/23 të datës 16.01.2023, për rishqyrtimin e vendimit të KK 01Nr. 07-104/02-33334/22 të datës 29.12.2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31 janar 2023 mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE 2023-2027

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani komunal, me tekstin e mëtejshëm "Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027".
2. Plani komunal nga pika 1 e këtij vendimi, mundëson zbatimin e politikave kombëtare në nivel lokal, orientimin strategjik të komunës drejt menaxhimit të integruar e të qëndrueshëm të mbeturinave, qasje të qartë të politikave të menaxhimit, mirëqeverisjen ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kuadrit rregullues ligjor.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Plani Komunal 01Nr. 104/02- 1493/23-Për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, i përmbledhur në 46 faqe.
4. Me këtë vendim, Anullohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, 01Nr. 07-104/02-33334/22 i datës 29.12.2022-për Aprovimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mursefi



Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027

Dhjetor 2022

<i>Fjala e Kryetarit të Komunës.....</i>	<i>5</i>
<i>1. Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave</i>	<i>6</i>
1.1. Qëllimi dhe fushëveprimi i planit	6
1.2. Baza ligjore për rishikimin e planit	7
1.3. Korniza institucionale	8
Popullsia	11
Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit.....	11
Të dhënat mbi ekonominë lokale	13
Bujqësia	13
Turizmi lokal	14
Arsimi	14
Shëndetësia	15
Administrata publike	15
Dokumentet relevante komunale	16
1.5. Të dhënat për mbeturina në komunë.....	17
1.6. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave.....	17
1.7. Rishikimi i implementimit të planit	20
1.8. Performance e shërbimit	24
1.9. Performanca financiare e MM	25
1.10. Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave	26
1.10.3. Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave	26
<i>2. Objektivat e MM dhe plani operacional</i>	<i>27</i>
2.5. Vizioni i MM.....	27
2.6. Objektivat dhe caqet e MM	27
<i>3. Plani i MM në kushte emergjente.....</i>	<i>41</i>
<i>4. Plani financiar, i veprimit dhe i monitorimit</i>	<i>42</i>

Lista e shkurtesave:

AMMK	Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BMZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillime ekonomik
CEDE	Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit
DRS	Sistemi i kthimit të depozitës
ELV	Automobila mbeturinë
EPR	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
GIZ	Shoqëria gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar
QeK	Qeveria e Kosovës
ITMB	Impijanti për trajtimin mekanik biologjik
IËMS	Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KfE	Kreditanstalt für Eiederaufbau
KIËER	Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit
KLMC	Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
MESPI	Ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës
MND	Mbeturina nga ndërtim demolimi
MPEE	Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike
MRF	Qendra e rikuperimit të materialit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PKMM	Plani komunal për menaxhim të mbeturinave
PPP	Partneriteti publiko-privat
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
SIMM	Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave
ËFD	Direktiva kornizë e mbeturinave

Lista e tabelave

Tabela 1	Të dhënat mbi popullatën
Tabela 2	Bilanci i mbeturinave komunale
Tabela 3	Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale
Tabela 4	Mbulimi me shërbim në territorin e komunës
Tabela 5	Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit
Tabela 6	Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit
Tabela 7	Pajisjet për hudhjen, ruajtjen dhe grumbullimin e mbeturinave
Tabela 8	Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave
Tabela 9	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM, aktual
Tabela 10	Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM
Tabela 11	Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave
Tabela 13	Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM
Tabela 14	Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit
Tabela 15	Lista e objektivave të planit
Tabela 16	Korniza strategjike e Objektivit 1
Tabela 17	Korniza strategjike e Objektivit 2
Tabela 18	Parashikimet demografike të popullatës
Tabela 19	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave
Tabela 20	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit
Tabela 21	Analiza e potencialit të mbeturinave që mundën të ricikohen
Tabela 22	Orari i ndarjes së mbeturinave në burim
Tabela 23	Korniza strategjike e objektivit 3
Tabela 24	Strategjia e zgjerimit me shërbim
Tabela 25	Efikasiteti i stafit
Tabela 26	Korniza strategjike e objektivit 4
Tabela 27	Korniza strategjike e objektivit 5
Tabela 28	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 1 „Parandalimi dhe reduktimi“
Tabela 29	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“
Tabela 30	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“
Tabela 31	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 4 „Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit“
Tabela 32	Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“

Fjala e Kryetarit të Komunës

Për komunën e Kaçanikut, që nga fillimi i funksionimit të saj, menaxhimi i mbeturinave është konsideruar si një sfidë me të cilën kjo komunë duhej të përballej dhe të gjejë një zgjidhje afatgjatë. Nevoja për investime në kushte e rrethana të kufizuara financiare, nevoja për ndërgjegjësimin e qytetarëve por edhe problemet në interpretimet ligjore kanë bërë që kjo sfidë të jetë aktuale edhe sot e kësaj dite.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, komunat janë kompetente për sigurimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë këtu furnizimin me ujë, kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave, mirëpo mospërputhja e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe pronësia e ndërmarrjeve publike ka bërë që problematika e menaxhimit të mbeturinave të ngritet në një nivel më të lartë të shqyrtimit dhe analizës. Sipas Ligjit për Mbeturinat, komunat kanë të drejtë t'i përgatisin planet e veta lokale për menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe t'i bëjnë planet e duhura operative për grumbullimin e mbeturinave në mënyrë më efektive.

Sidoqoftë, angazhimi i komunës si institucion që të vihet në shërbim të qytetarëve asnjëherë nuk është vënë në pyetje, pa marrë parasysh sfidat dhe problemet qoftë financiare, funksionale apo ligjore.

Në këtë drejtim përgatitja e një dokumenti për "menaxhimin e mbeturinave" vetëm sa e dëshmon seriozitetin dhe përkushtimin e komunës së Kaçanikut që këtij problemi t'i qaset me tërë kapacitetin e vet, dhe të jetë komuna e parë në Republikën e Kosovës që do ta ketë një dokument gjithëpërfshirës.

Harmonizimi i këtij dokumenti me legjislacionin kombëtar dhe Direktivat e BE-së na bënë të besojmë se kemi arritur të hartojmë një strategji afatgjatë të menaxhimit të mbeturinave.

Koncepti i detajuar për menaxhimin e mbeturinave në qytet dhe në vendbanimet rurale të Kaçanikut, themelimi i një rrjeti funksional për grumbullimin e mbeturinave, krijimi i një plani për menaxhimin e mbeturinave dhe mbështetja financiare e programeve për ngritjen e vetëdijes publike si dhe themelimi i një ndërmarrjeje publike që i parasheh ky dokument, do të jetë strategjia e komunës së Kaçanikut për ta menaxhuar këtë problematikë në mënyrë afatgjatë. Për të ardhur deri te ky dokument është dashur kohë, angazhim dhe përkushtim i grupit punues të komunës së Kaçanikut i cili në mënyrë të veçantë e ka shtjelluar këtë problematikë në përputhje me planet zhvillimore strategjike.

Në veçanti falënderojmë partnerët tanë nga Projekti GIZ-SMS, BE-së, dhe organizatave KIËER dhe CEDE që kanë ofruar mbështetje në procesin e rishikimit të planit komunal duke punuar ngushtë me grupet punuese të komunës.

*Kryetari i Komunës
Besim Ilazi*

1. Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

1.1.Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM) është një dokument udhëzues dhe planifikues, i cili mundëson zbatimin e politikës kombëtare të mbeturinave në nivel komunal. Ky plan mundëson orientimin strategjik të komunës së Kaçanikut drejt një menaxhimi të integruar e të qëndrueshëm të mbeturinave. Qëllimi i këtij plani është të parashtrojë një qasje të qartë të politikave të menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal dhe të kontribuojë në mirëqeverisjen e komunës së Kaçanikut në fushën e menaxhimit të mbeturinave komunale duke ngritur kapacitetet, dhe duke përmirësuar kuadrin rregullator të menaxhimit të mbeturinave komunale.

PKMM promovon zgjidhjet e mundshme teknike efektive për menaxhimin e integruar të mbeturinave, që përfshin instalimin e sistemeve të reja të grumbullimit të mbeturinave me qëllim, re-duktingun e mbeturinave dhe nxitjen e riciklimit në zonat e caktuara të komunës. Ai vendos drejtimit e politikave lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për vitet e ardhshme, në varësi të angazhimit financiar të Qeverisë për menaxhimin e mbeturinave në komunë.

PKMM synon të mbrojë mjedisin dhe të sigurojë kushte për jetesë të shëndetshme, të nxisë rritjen e cilësisë së jetës, të mbështesë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm; dhe të gjenerojë punësim dhe të ardhura.

Prioritetet e PKMM janë:

- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në territorin e Komunës së Kaçanikut;
- Përmirësimi i menaxhimit të deponive të mbeturinave komunale;
- Promovimi i ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave dhe krijimin e sistemeve funksionale;
- Rritjen e inkasimit për grumbullimin e mbeturinave,
- Eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave dhe rehabilitimi i zonave të ndotura nga mbeturinat;
- Promovimin e ripërdorimit dhe riciklimit të materialeve ndërtimore;
- Rritjen e ofrimit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave deri 100%.

1.2.Baza ligjore për rishkrimin e planit

1.2.1. Korniza ligjore

Akti themelor për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është Ligji Nr.04/L-060 për Mbeturinat dhe Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ndërmjet tjerash ofron parimet bazë mbi menaxhimin e mbeturinave përfshirë, klasifikimin e mbeturinave si dhe rolet e përgjegjëseve të aktorëve kyq në menaxhimin e tyre, si aspektet e operimit, dhe licencimit të operatorëve.

Në mënyrë specifike Ligji Nr.04/L-060 për Mbeturinat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-071 për Mbeturina, përmes Neni 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunitat sipas këtij Neni, janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar në masë të konsiderueshme me direktivat përkatëse të KE që e rregullojnë lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligje përfshijnë: **Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.**

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të komunave, përfshirë edhe aspektet e menaxhimit operativ dhe financiar të shërbimit dhe buxhetimit .

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndërmjet tjerash rregullon aspektet relevante të pronësisë së ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen kooperative, transparencën financiare, dhe formimin e ndërmarrjeve komunale.

Baza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal të Komuna e Kaçanikut përfshinë:

- Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Kaçanikut;

Dokumentet tjera planifikuese-ligjore në lëmin e menaxhimit të mbeturinave janë edhe:

- **Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë-** dokument strategjik që synohet të arrij zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe të ndikoj në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Dokumenti synon të trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar objektivat strategjike.

Dokumente strategjike në nivel lokal që rregullojnë dhe trajtojnë aspektet e menaxhimit të mbeturinave:

Draft Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Kaçanikut- Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Kaçanikut, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike. Si masa në kuadër të planit për menaxhimin e mbeturinave janë planifikuar: eliminimi i deponive jo formale të mbeturinave dhe parandalimi i krijimit të tyre dhe caktimi i një lokacioni për mbeturinat inerte sipas UA 08/2017 MMPH.

1.3.Korniza institucionale

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq, sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin mbi Mbeturina dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe Komunitet e Kosovës.

Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat toksike, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunitet nga ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte dhe nga demolimet, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPH dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave, strategjisë për menaxhimin e mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjen e licencave për operatorët; (iv) dhe krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunave dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik** - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshirë Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- **Ministria e Shëndetësisë** - Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- **Ministria e Punëve të Brendshme** – Bën koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat.
- **Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit** - është përgjegjes për rregullimin e aspekteve të menaxhimit me mbeturinat me prejardhje shtazore;

- **Dogana e Republikës së Kosovës** - kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave
- **Policia e Republikës së Kosovës** - bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur si në vijim:

- **Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (DSHPE)** - është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera publike. DSHPE është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave komunale dhe atyre nga ndërtimi dhe demolimi,
- **Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUKMM)** është përgjegjëse për caktimin e një lokacioni për deponimin e mbeturinave inerte. DUKMM, është përgjegjëse edhe për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit.
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa** - është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- **KRM "Pastërtia" njësia në Kaçanik** - ofron shërbim sipas statutit të saj duke ushtruar kompetenca ekzekutive.

1.4. Kontesti Lokal

Pozita gjeografike dhe klima

Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, përfaqësohet në gjerësinë gjeografike $42^{\circ} 13' 40''$ dhe gjatësinë gjeografike $21^{\circ} 15' 31''$. Përfshinë përfaqësohet 306 km² dhe kufizohet me komunën e Ferizajt në veri, Vitinë në verilindje, Shtërpçen në perëndim dhe Hanin e Elezit në jug. Gjatësia e vijës totale kufitare është 101,41 km², me sipërfaqe prej 210,90 km². Distanca më e largët në territorin e komunës është 22,3 km në mes fshatrave Sllatinë në perëndim dhe Korbliq në lindje. Në drejtimin veri-jug, dallimet nuk janë aq të theksuara. Sipërfaqja e komunës nuk ka ndonjë formë të rregullt por është mjaft e thyer. Relievi i shprehur malor ndikon në shtrirjen e rrugëve dhe vështirëson lidhjen e vendbanimeve me qendrën komunale. Kaçaniku, ndodhet në një lartësi 471m deri 520m mbi nivelin e detit.

Komuna e Kaçanikut ka klimë të mesme kontinentale, në kushte normale. Temperatura mesatare vjetore është 10.2 gradë C, muaji më i ngrohtë i vitit është korriku me temperaturë mesatare 20.6 gradë C, kurse muaji më i ftohtë i vitit është janari me temperaturë mesatare -1.4 gradë C.

Sasia vjetore e reshjeve është 861.4 mm ku maksimumi i reshjeve paraqitet në vjeshtë dhe në dimër. Llojet kryesore të reshjeve janë: reshjet e shiut të cilat më shumë bien në stinën e pranverës dhe të vjeshtës dhe reshjet e borës të cilat bien gjatë stinës së dimrit.

Resurset minerare dhe natyrore

Resurset minerare- Kaçaniku ka resurse të mëdha natyrore e sidomos mineraleve të ndryshme si gurë gëlqeror, argjile por edhe minerale tjera të cilat deri më tani nuk janë hulumtuar. Janë konstatuar rezerva të gurit gëlqeror në kepin e Kaçanikut prej 127 milion ton dhe po ashtu 25 milion ton, rezerva të gurit gëlqeror në Ivajë, ndërsa ka edhe sasi tjera ende të pa hulumtuara.

Resurset ujore – Komuna ka burime të mjaftueshme natyrore të ujit nga Malet e Sharrit, e bëjnë më të lehtë furnizimin për qytetarët me ujë të pijes. Rrjedha të mjaftueshme të përrojeve, përrockave si dhe dy lumenjëve të cilët kalojnë nëpër territorin e Komunës (lumi Lepenc dhe Nerodime), shfrytëzohen për ujitjen e kulturave bujqësore, gjë që favorizon edhe më shumë zhvillimin e bujqësisë. Nëpër territorin e komunës së Kaçanikut, Lepenci ka gjatësi rreth 18 km, në territorin e komunës lumi hyn në fshatin Bajnicë (610 m lartësi mbidetare) dhe rrjedh në drejtim lindje-perëndim. Në fshatin Soponicë merr drejtim jugor dhe e lëshon territorin komunal 14 në fshatin Gjurgjedell (710 m lartësi mbidetare). Në komunë Lepenci ka rënie të tërësishme 214m ose rënje mesatare 11,8m/km. Gjerësia e lumit sillet 11 deri 20 m me thellësi mesatare 40 deri 60 cm, maksimale sillet edhe 2 m. Shtratin e ka të ndërtuar nga rëra, zhavorri dhe blloqe të shkëmbinjve që sjell lumi me fuqinë e tij gjatë niveleve të larta.

Resurset pyjore - Komuna ka 12,449.98 hektar pyje, e cila mbulon 59.1 % të sipërfaqes së komunës. Pjesa më e rëndësishme dhe me vlerat më të larta natyrore e pyjeve shtrihet në

kuadër të territorit të Parkut Kombëtarë “Sharri”, 11% e teritorit të së cilit shtrihen në territorin e komunës. Këto pyje shquhen edhe për pasurinë e trashëgimisë natyrore që ofrojnë me një biodiversitet të pasur, por edhe për shkak të potencialit të tyre për zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve tjera me rëndësi ekonomike. Resurse tjera pyjore me rëndësi që shtrihen në territorin komunës së Kaçanikut, janë pyjet e dushkut që shtrihen përgjatë Grykës së Kaçanikut, dhe Kompleksi i pishave në Strazhë me sipërfaqe prej 25 ha.

Popullsia

Komuna e Kaçanikut sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, kishte 33,409 banorë dhe 5547 ekonomi familjare, me 50.8 meshkuj dhe 49.2 femra dhe me madhësi mesatare të ekonomisë familjare 6.9 anëtarë. Komuna ka popullsi relativisht të re ku mosha mesatare e popullsisë është 28,3 vjeç. Në përgjithësi grupmoshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës. Rreth 40% e popullsisë së përgjithshme në komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç, 54,4% janë të moshës 20 deri 64 vjeç, ndërsa grupmoshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje të vogël me 5,6% të popullsisë së përgjithshme të Kaçanikut.

Sipas vlerësimit të ASK-së për vitin 2021, Komuna e Kaçanikut kishte 34988 banorë, që shënon një rritje prej 1.7% të numrit të banorëve krahasuar me numrin e banorëve në regjistrimin e vitit 2011 (tabela 1). Sa i përket migrimit sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2021 në Komunën e Kaçanikut kishte një migrim prej 290 banorëve, përfshirë migrimet ndërkombëtare dhe ato kombëtare, përkundër 59 imigrimeve.

Tabela 1: Të dhënat mbi popullatën			
Regjistrimi ASK 2011		Vlerësimi ASK 2021	
Numri i populates	Numri i amvisërive	Numri i populates	Ngritje / zbritje %
33409	5547	34988	1.7%

Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit

Kontaminimi i tokës dhe ujit, me mbetjet e ngurta dhe ujërat e zeza, guroret, degradimi i pyjeve, humbja e tokës bujqësore përmes ndërtimit të paligjshëm janë kërcënime aktuale nëpër tërë territorin e komunës.

Ndotja e ajrit - Të dhënat për cilësinë e ajrit në Kosovë, janë të mangëta për shkak të mungesës së një sistemi për monitorimin e cilësisë së ajrit. Gjithashtu, inventari i ndotësve nuk është zhvilluar ende nga kadastra e ndotësve të ajrit. Si rezultat i kësaj gjendje nuk mund të flasin me kompetencë për nivelin aktual të ndotjes dhe cilësinë e tij. Bazuar në njohuritë e përgjithshme sondazheve në terren, burimet kryesore të ndotjes në komunën e Kaçanikut mund të konsiderohet se janë: ndezja e mbetjeve të plastikës dhe gomës, gurëthyesit, ndezja e mbetjeve në deponi të egra, trafiku rrugor, sidomos në afërsi të rrugëve rajonale e nacionale, me një përqëndrim më të theksuar në qytetin e Kaçanikut, ngrohja nga amvisëritë, etj.

Cilësia e ujërave - Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe jo adekuat të menaxhimit të tyre. Ky rrjet shkakton derdhjen e ujërave të zeza pa trajtim paraprak, me një ndikim negativ në cilësinë e ujit si dhe në jetën bimore dhe shtazore. Pasojat e kësaj ndotje mund të shkojnë edhe më tej duke shkaktuar ndikime negative në tokë dhe në ajër. Si përgjigje ndaj kësaj dukurie, dhe me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore, komuna është duke e ndërtuar sistemin kryesor të kanalizimit ku do të përfshihen rreth 70% të fshatrave të komunës së bashku me qytetin e Kaçanikut.

Ndotja e tokës - Mbeturinat e ngurta të akumuluar në deponitë ilegale janë ndër ndotësit kryesorë të tokës në komunë. Këto janë kryesisht deponi ilegale të mbeturinave shtëpiake, dhe në disa raste mbetjeve të ndërtimit, të cilat kryesisht gjenden në afërsi të rrugëve. Ndikimet negative të këtyre deponive janë të shumta, ku përveç kontaminimit të drejtpërdrejtë të tokës dhe ajrit, ndikimi i tyre mund të bartet në rrjedhat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nëpërmjet reshjeve. Drejtoria e Shërbimeve Publike për çdo vit e bën evidentimin e deponive ilegale dhe organizon pastrimin e tyre.

Zhurma - Sa i përket ndotjes nga akustika, nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme. Fakti që përmes territorit të komunës kalon autostrada që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut, rruga nacionale Prishtinë - Shkup, është e ndikuar nga zhurma. Gjithashtu ndotësit tjerë janë veprimtaritë përpunuese/industriale siq janë, fabrika e Silcaporit pranë vendbanimit Doganaj dhe gërmimet grumbulluese (gurthyesit) brenda territorit të komunës.

Zonat e mbrojtura- Rreth 11% e territorit të Parkut Kombëtarë “Sharri”, shtrihet në territorin e Komunës së Kaçanikut dhe paraqet një ndër zonat më vlera të larta të trashëgimisë natyrore. Zonë e rëndësishme natyrore në komunë është edhe Kompleksi i pishave në Strazhë me sipërfaqe prej 25ha. Zona të tjera të mbrojtura në territorin e komunës janë edhe: Shpella e Shullanit në Sllatinë, Humnera në shpatin e Qenarës Gllloboçicë, Trungu i Qarrit në Kaçanik të Vjetër, Guri i gjatë në Stagovë, Guri i Zi në Llanishtë, Trungu i Qarrit në Kovaqec, Trungjet e Bungut në Bob, Kompleksi i trungjeve të dushkut në Runjevë, Trungu i Shelgut në Kaçanik, Trungjet e dushkut në Ivajë dhe Trungu i Qarrit në Kotlinë.

Flora dhe Fauna- Ndërtimi gjeologjik, peisazhi dhe kushtet klimatike kanë ndikuar që në një hapësirë relativisht të vogël të rezervuarit të lumit Lepenc dhe Nerodime të shfaqen karakteristika të ndryshme të shtresave bimore. Sa i përket florës, drunjtë që rriten në këtë territor janë: ahu kryesisht në zonën e bjeshkës së Lubotenit, lisi, thana, shkoza, ahu në Gryken e Kaçanikut. Nga barishtet rritet lulëkuqja (peonia decore), si dhe bimët mjekësore si bar-veshi, barpezmi, etj. Fauna në malet e Sharrit karakterizohet me kafshë të egra si luqerbulli, ariu, macja e egër, shqiponja, dallëndyshja, lejleku, bilbili, etj. Duke e pasur

parasysh shtrirjen e sipërfaqeve pyjore në pjesët lindore dhe perëndimore kodrinore të territorit komunal, të pasura me një shumëllojshmëri të botës bimore dhe shtazore, si dhe korridoret përgjatë lumenjve që shtrihen përgjatë territorit komunal duke i lidhur këto tërësi pyjore, mund të thuhet se Komuna e Kaçanikut shquhet me një rrjet ekologjik i cili është i shpërndarë përgjatë tërë teritorit të saj.

Të dhënat mbi ekonominë lokale

Kaçaniku ka një numër të avantazheve për nga karakteri ekonomik. Pozicionimi gjeografik i garanton lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore dhe një pikë-kalim kufitar në Gllaboçicë dhe tjetri në afërsi të portit kryesor të Hanit të Elezit. Mallërat dhe njerëzit që hyjnë në Kosovë apo largohen prej saj kalojnë përmes dhe përskaaj Kaçanikut. Komuna vazhdon të ketë furnizim të pasur me lëndë të para për industrinë e ndërtimit, industrinë e drurit dhe atë të ujit. Aktivitet aktuale të Komunës vazhdojnë të koncentrohen drejt forcimit dhe rritjes ekonomike për ta bërë kështu Kaçanikun një vend edhe më të përshtatshëm dhe më tërheqës për bizneset lokale – vendore, me theks të veçantë për investime të huaja.

Në kuadër të politikave ekonomike, Komuna e Kaçanikut ka krijuar tri (3) zona ekonomike - dy zona industriale dhe një zonë komerciale. Këto zona kanë vendosje strategjike për çasje të mirë të transportit dhe vazhdimisht po angazhohemi drejtë funksionalizimit të këtyre zonave (krijimit të infrastrukturës) me qëllim të rritjes konkrete të punësimit. Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve.

Nga 4 ndërmarrje shoqërore që kanë vepruar në tërriton e komunës 2 nga to (“Lepenci” dhe “Silcapor”) janë privatizuar, ndërkaq, NTSH- Tregtia “Sharri” është në procedurë të privatizimit, dhe nuk merret me veprimtarinë themelore, por me dhënien e pronës me qira, kurse NPSH “Sankosi” ka statusin e ndërmarrjes aksionare dhe merret me prerje dhe qepje – konfeksion.

Sa i përket strukturës së bizneseve në komunën e Kaçanikut nga 838 biznese të regjistruara ato që kanë aktivitet tregtinë, janë dominuese me 376 biznese ose 45 %, prodhimi përfaqësohet me 82 biznese ose 10 %, ndërtimtaria me 51 biznese ose 6 %, turizmi dhe hoteleria me 92 biznese ose 11 %, transporti me 161 ose 19 %, shpedicioni me 6 biznese ose 0.7 % dhe shërbimet tjera me 70 biznese ose 8 %.

Bujqësia

Kaçaniku ka burime natyrore të mjaftueshme të ujit nga Malet e Sharrit, si dhe rrjedhje të mjaftueshme të përrojeve, përrockave si dhe dy lumenjëve të cilët kalojnë përgjatë territorit të Komunës (Lumi Lepenc dhe Nerodime), të cilët shfrytëzohen për ujitjen e kulturave bujqësore, gjë që favorizon edhe më shumë zhvillimin e bujqësisë.

Sa i përket bujqësisë Komuna e Kaçanikut ka: 3086.87 hektarë ara, 2367.53 hektarë kullosa, 2008.25 hektarë livadhe, 1.58 hektarë kopshte, 115.90 hektarë pemishte dhe 2.78 hektarë vreshta. Tokat e punueshme shfrytëzohen për të siguruar ushqim për kafshë dhe për kultivimin e kulturave lavërtare: grurë, misër dhe perime. Sa i përket sektorit të pemëtarisë, Komuna e Kaçanikut ka mbështetur ngritjen e plantacioneve me mollë për 20 hektarë, ndërsa që kultivohen dardhët, kumbullat, mjedrat dhe manaferrat. Komuna ka mbështetur zhvillimin e ekonomisë bujqësore lokale, edhe përmes sigurimit të 21,000 m² serra, apo

2.14 ha për 214 ekonomi familjare. Kjo mbështetje ka treguar rezultate premtuese në prodhimin e kulturave perimore (tranguj, domate, specat, sallatë e gjelbërt, etj.).

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë për Kaçanikun ka rëndësi të veçantë, si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në përgjithësi. Si rezultat i mbështetjes së këtij sektori të ardhurat neto në fermë janë rritur ndjeshëm. Sektori i Bujqësisë, përmes politikave dhe strategjive të zhvillimit do të jetë edhe në të ardhmen i orientuar në mbështetjen e faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe krijimin e një ambienti më të favorshëm zhvillimorë.

Turizmi lokal

Kaçaniku vlerësohet si një ndër komunat me potencial të mirë për zhvillimin e turizmit, me disa lokalitete që shquhen për bukuri natyrore dhe vlera historike. Në territorin e kësaj komune ndodhet “Maja e Lubotenit”, që paraqet një nga pikat kryesore të potencialeve turistike që shtrihet në zonën e Maleve të Sharrit, e që i përket territorit të komunës së Kaçanikut. Kjo zonë përveq peisazheve natyrore ofron edhe shtigje të ecjes dhe ngjitjes duke mundësuar zhvillimin e turizmit malor dhe ekoturizmit, ndërsa gjatë stinës së dimrit zhvillimin e sportit të skijimit.

Gryka e Kaçanikut, është një zonë tjetër me rëndësi historike specifike për mbarë shqiptarët. Aty u zhvilluan betejat vendimtare për çështjen kombëtare dhe me një bukuri natyrore të spikatur, të gjitha këto e bëjnë tërheqëse për shumë vizitor nga Kosova dhe trevat tjera shqiptare. Shtëpia e Kulturës, 'Xheladin Kurtaj', e njohur si vendshpallja e Kushtetutës së Kosovës – Ky objekt specifik ku u shpall kushtetuta e Kaçanikut, Kushtetutë për Republikën e Kosovës në vitin 1990, është bërë vend mjaft i frekuentuar për rëndësinë e saj historike për Kosovën dhe mbarë shqiptarët.

Zona tjera me potencial turistik janë edhe “Kalaja” dhe “Xhamija e Vjetër” në zonën e qytetit. Të gjitha këto karakteristika gjeografike, e bëjnë këtë komunë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit dhe me një klimë të përshtatshme. Komuna ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve profesionale për ofrimin e shërbimeve turistike, duke u bazuar në përvojat e mira për turizmin e qëndrueshëm, nderkaq që mungon infrastruktura që do i mbështeste aktivitetet turistike në harmoni me vlerat natyrore dhe kulturore.

Arsimi

Arsimi në Komunën e Kaçanikut zhvillohet në tri nivele, atë parashkollorë, fillorë dhe të mesëm me 6,002 nxënës. Ekziston vetëm një çerdhe për fëmijë që shërben edhe për nevojat e parashkollorëve.

Arsimi parashkollor- Në Qendrën për Edukimin dhe Arsimin Parashkollorë (QEAP) me qëndrim tërë ditore zhvillohet edukimi dhe arsimi për fëmijët e moshës nga 9 muaj deri në 6 vjeç, ku aktualisht ka të regjistruar 70 fëmijë.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët – zhvillohet në 12 shkolla të mësimit fillor dhe të mesëm të ulët me 11 paralele. Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 4318, prej të cilëve 2218 apo 51.36 % meshkuj dhe 2100 apo 48.64 femra. Ndërkaq numri i mësimdhënësve në këto dy nivele është 358, që e jep një mesatare të përafërt me 12,06 mësimdhënës për kokë nxënësi.

Arsimi i mesëm i lartë - Në kuadër të këtij niveli funksionojnë dy institucione arsimore: Gjimnazi “Skënderbeu” dhe Shkolla e Mesme Profesionale “Feriz Guri e Vëllezërit Çaka”. Në të dy shkollat mësimi zhvillohet në dy ndërrime. Numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë nivel shkollor është 1158, prej tyre 661 (384 femra) në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe 497 (114 femra) në SHMP, ndërkaq numri i mësimdhënësve në këtë nivel është 94, apo përafërsisht 12,31 mësimdhënës për kokë nxënësi.

Shëndetësia

Në Kaçanik, funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF). Ndërtimi i saj është bërë në vitin 2016/2017. Gjendja fizike është shumë e mirë dhe ofron shërbime për qytetarët 24 orë në ditë. QKMF ofron këto shërbime: ekzaminim i përgjithshëm, ekzaminime të brendshme të specializuara, pediatri, analiza laboratorike, trajtim urgjent, rreze rëntgen dhe stomatologji. Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) janë gjithsej 6 dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) po ashtu janë 6.

Numri i mjekëve është 20, kurse numri i përgjithshëm i punëtorëve shëndetësor është 110, apo 1.8 punëtorë shëndetësor për 1,000 banorë, duke e bërë Kaçanikun komunën me më së paku punonjës shëndetësor në Kosovë.

Objekti QKMF ofrohet në një ndërtesë me dy etazhe me një hapësirë 1100m² dhe objekti i emergjencës me 200m². Gjatë një viti në këtë qendër shërbime shëndetësore u janë ofruar 125,460 pacientëve prej të cilëve 52,396 vizita dhe 73,064 intervenime. Ku të gjitha shërbimet shëndetësore janë realizuar pothuaj se falas sepse 88.48% e shërbimeve kanë qenë pa participim.

Administrata publike

Administrata e Komunës përbëhet nga zyra e kryetarit të komunës dhe drejtoritë përkatëse. Janë nëntë drejtori: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari; Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport; Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Zhvillim dhe Turizëm. Në administratën e komunës janë të punësuar 197 punonjës në administratën publike.

Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet është njëra nga departamentet më të rëndësishme në Komunë. Kjo drejtori shquhet për përkrahje të investitorëve e bizneseve lokale dhe zhvillim ekonomik të Komunës, ndërsa stafi i angazhuar ofron shërbime dhe këshilla duke filluar nga regjistrimet e bizneseve deri tek përkrahja e investitorëve.




Figura 1: Organogrami i Komunës

Pjesa e legjislativit të Komunës, përbëhet prej Kryesuesit të Kuvendi Komunal, komiteteve dhe komisionet përkatëse. Asambleja komunale ka 27 vende.

Dokumentet relevante komunale

Plani Zhvillimor Komunal 2022-2031- Ky dokument i rëndësishëm komunal që është bazë për zhvillim të qëndrueshëm të komunës është në proces të hartimit. Në kuadër të këtij Plani, si masa për menaxhimin e mbeturinave janë planifikuar: eliminimi i deponive jo formale të mbeturinave dhe parandalimi i krijimit të tyre dhe caktimi i një lokacioni për mbeturinat inerte sipas UA 08/2017 MMPH.

Harta Zonale e Komunës- Harta Zonale, është dokument i cili përcakton perspektivën e zhvillimit të ardhshëm të komunës. Përmes këtij dokumenti, Komuna do të rregullojë aspektet e planifikimit hapësinorë dhe ndarjen e zonave urbane dhe rurale në tërë komunën, sipas standardeve të përcaktuara në ligjin për Planifikimin Hapësinorë. Aktualisht komuna nuk ka Hartë Zonale, mirëpo ky dokument do të përgaditet krahas aprovimit të Plani Zhvillimor Komunal.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis- Dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjeqare. Komuna e Kaçanikut aktualisht nuk e ka të hartuar këtë dokument, por është marrë vendimi dhe është formuar komisioni përkatës komunal për hartimin e dokumentit.

Plani i Reagimit Emergjent për Komunën e Kaçanikut – Një dokument strategjik lokal i hartuar në vitin 2019 sipas kërkesave të Ligjit për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe

Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/-L-027. Ky dokument shërben si udhëzues për mbrojtje, shpëtim dhe në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Në këtë dokument nuk ka ndonjë objektivë apo masë specifike parandaluese që ndërlidhet me menaxhimin e mbeturinave.

1.5. Të dhënat për mbeturina në komunë

Gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave

Në mungesë të të dhënave specifike për kompozicionin e mbeturinave për komunën e Kaçanikut janë marrë si vlerësim i përafërt të dhënat nga hulumtimi për kompozicionin e mbeturinave në regjionin e Ferizajt.

Tabela 2: Bilanci i mbeturinave komunale							
Kategoria	Mënyra e përcaktimit të sasisë	Mbeturinat e grumbulluara			Mbeturinat e dorëzuara		
		Nga operatorët e grumbullimit (ton/vit)	Nga ricikluesit	Nga deponitë ilegale	Mbeturinat e ricikluara	Mbeturinat e tregtuara	Mbeturinat e deponuara (ton/vit)
Letër dhe karton	14%	5,887	N.A	N.A	N.A	N.A	5,887
Qelq	3.5%	1,471	N.A	N.A	N.A	N.A	1,471
Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	34%	14,297	N.A	N.A	N.A	N.A	14,297
Tekstil dhe veshjet	7.5%	3,153	N.A	N.A	N.A	N.A	3,153
Pllastika	21%	8,830.5	N.A	N.A	N.A	N.A	8,830.5
Metal	2%	841	N.A	N.A	N.A	N.A	841
Mbeturinat tjera komunale ¹	18%	7,569	N.A	N.A	N.A	N.A	7,569
Total:	100%	42,050	N.A	N.A	N.A	N.A	42,050

1.6. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

Në komunën e Kaçanikut, organizmi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave bëhet në kuadër të kompanisë regjionale të mbeturinave KRM “Pastërtia” me seli në Ferizaj. Mbulimi i zonës, e shprehur në përqindje 80%² prej amvisërive. Kjo ka mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave në disa lokalitete. Operatori dytë i përfshirë në sektorin e MM, N.P. “Krasniqi” është prezent në lokalitetet paraurbane: **Kaçanik i Vjetër, Begracë dhe Doganaj.**

¹ Mbeturinat bio-degraduese nga parqet, mbeturinat nga tregjet, etj.

² Raporti për menaxhimin e mbeturinave komunale 2021, AMMK 2022

Tabela 3: Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale

	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e menaxhuar e mbeturinave	Mbulimi me shërbim %	Statusi i kontraktimit (po/jo)
Operatori 1	KRM "Pastërtia"	Publike	Komunale dhe Shtazore	69.1	Po
Operatori 2	N.P. "Krasniqi"	Private	Komunale	10.8	Po

Mbulimi me shërbim:

Sipas të dhënave nga Raporti për menaxhimin e mbeturinave komunale 2021, mbulueshmëria me shërbim për grumbullimin e mbeturinave nga kompania publike ofrohet për 3847 dhe nga operatori privat NP "Krasniqi" për 598 ekonomi familjare nga gjithsejt 5547 ekonomi familjare, apo 80%. Shërbimi për grumbullimin e mbeturinave ofrohet 100% për institucione dhe 100% për biznese (Tabela 4).

Tabela 4: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës

Emri i operatorit	Numri i EF	Numri i EF të shërbyera	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
Operatori No.1	5547	3847	306	299	35	35
Operatori No.2		598		7		0

Tabela 5 prezanton, mbulimin me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave sipas vendbanimeve. Në komunën e Kaçanikut, ende nuk ofrohet shërbimi për ndarjen e mbeturinave në burim.

Tabela 5: Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit

Nr.	Vendbanimi	Numri i EF	Numri EF të shërbyera	Mbulimi me shërbim %	Numri EF me ndarje në burim	EF me ndarje në burim %	Lloji i ndarjes së mbeturinave
2.	Kaçanik	1826	1665	91%	N/A	N/A	N/A
3.	Bob	218	206	94%	N/A	N/A	N/A
4.	Dubravë – Vatë	428	310	72%	N/A	N/A	N/A
5.	Biçec	250	223	89%	N/A	N/A	N/A
6.	Soponicë	157	151	96%	N/A	N/A	N/A
7.	Stagovë	220	202	92%	N/A	N/A	N/A
8.	Kovaçec	175	156	89%	N/A	N/A	N/A
9.	Duraj – Gabrricë	109	85	78%	N/A	N/A	N/A
10.	Elezaj	105	81	77%	N/A	N/A	N/A
11.	Nikaj	125	95	76%	N/A	N/A	N/A
12.	Doganaj	174	144	83%	N/A	N/A	N/A
13.	Gllloboçicë	147	130	88%	N/A	N/A	N/A
14.	Rekë	127	82	65%	N/A	N/A	N/A
15.	Runjevë	128	121	94%	N/A	N/A	N/A
16.	Begracë	325	178	55%	N/A	N/A	N/A
17.	Kaçanik i Vjetër	459	225	49%	N/A	N/A	N/A
18.	Koxhaj	106	70	66%	N/A	N/A	N/A
19.	Ivajë	43	43	100%	N/A	N/A	N/A

20.	Gajre	62	58	93%	N/A	N/A	N/A
21.	Bajnicë	78	52	67%	N/A	N/A	N/A
22.	Gjurgjedell	42	36	86%	N/A	N/A	N/A
23.	Kotlinë	35	0	0%	N/A	N/A	N/A
24.	Gërlicë e Epërme	70	51	73%	N/A	N/A	N/A
25.	Strazhë	70	54	77%	N/A	N/A	N/A
26.	Sllatinë	16	10	62%	N/A	N/A	N/A
27.	Semajë	20	17	85%	N/A	N/A	N/A
28.	Llanishtë	18	0	0%	N/A	N/A	N/A
29.	Korbliq	6	0	0%	N/A	N/A	N/A
30.	Drenushë	8	0	0%	N/A	N/A	N/A
31.	Nikoc	0	0	0%	N/A	N/A	N/A
		5547	4445	80 %			

Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Në tabelën 6, janë prezantuar të dhënat për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në zonën e shërbimit të ndarë në tre seksione: zona urbane qendra, zona periurbane dhe zona rurale. Gjithashtu tabela ofron të dhëna edhe mbi tipologjinë e ofrimit të shërbimit dhe frekuencën e shërbimit.

Tabela 6: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit				
Vendbanimi	EF të shërbyera derë më derë %	Frekuenca e shërbimit	EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët %	Frekuenca e shërbimit
Zona urbane qendra	78.9%	7 herë në javë	21.1%	7 herë në javë
Zona periurbane ³	100%	1 herë në javë	0	1 herë në javë
Zona rurale	100%	1 herë në javë	0	1 herë në javë

Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Tabela 7, ofron të dhënat për asetet e KRM. “Pastërtia” dhe NP “Krasniqi” për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave dhe gjendjen teknike të tyre.

Tabela 7: Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave				
Lloji i kontejnerit	Numri	Gjendje të mire %	Gjendje funksionale %	Gjendje jo të mire %
Shporta 120 l	3823	90%	93%	7%
Shporta 240 l	0	0	0	0
Kontejnerë 1.1 m3 metalik	119	88%	96%	4%
Kontejnerë 1.1 m3 plastikë	0	0	0	0
Kontejnerë 5.1 m3	0	0	0	0
Kontejnerë 7.1 m3	0	0	0	0
Kontejnerë 30 m3 – Transfer	0	0	0	0

Në tabelën 8, janë prezantuar të dhënat për asetet e KRM. “Pastërtia” dhe NP “Krasniqi” për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.

Tabela 8: Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave

³ Banime rezidenciale, me shtëpi individuale

Mjetet e operatorit të parë KRM "Pastërtia"					
Brendi	Tipi	Kapaciteti ton apo m ³	Viti i prodhimit	Targat	Gjendja
Kompaktor	Iveko	7 m ³	2001	05-249-AB	Funksionale
Kompaktor	Scania	7 m ³	2006	05-399-FD	Funksionale
Kompaktor	Volvo	7 m ³	2003	05-821-EP	E keqe
Kompaktor	Mercedes	16 m ³	2021	05-691-GG	E mire
Kompaktor	Issusu	8 m ³	2021	05-206-GJ	E mire
Kompaktor	Issusu	8 m ³	2021	05-207-GJ	E mire
Kompaktor	Mercedes	8 m ³	2021	05- 695 - GG	E mire
Transportues	Mercedes	2 m ³	2004	05-819-EP	Funksionale
Mjetet e operatorit të dytë N.P. "Krasniqi"					
Brendi	Tipi	Kapaciteti ton apo m ³	Viti i prodhimit	Targat	Gjendja
Kompaktor	Mercedes	6374 ton	1999	05-592-DE	Funksionale
Kompaktor	Renault	4120 ton	2000	05-208-FF	Funksionale
Kompaktor	Iveco	5861 ton	1997	05-261-GA	Funksionale
Kompaktor	Man	6871 ton	1993	05-412-CI	Funksionale

1.7. Rishikimi i implementimit të planit

Në kuadër të procesit të hartimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, komuna e Kaçanikut ka bërë edhe vlerësimin e implementimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021.

Komuna ka bërë një analizë të realizimit të objektivave të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021, me qëllim që të ketë një pasqyrë më të qartë për hartimin e objektivave të rinjë dhe caktimin e caceve të performancës për periudhën e ardhshme pesëvjeqare.

Në tabelën në vijim janë listuar objektivat e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre.

Sipas tabelës së prezantuar nga gjithsejtë 14 objektiva të planifikuara, disa prej tyre janë realizuar në masën 100%, ka objektiva që janë realizuar në masën shumë mirë ose kënaqshëm, disa prej tyre janë zbatuar në nivel jo të mirë ose jo të kënaqshëm dhe disa prej tyre, në nivelin e dobët ose nuk ka filluar fare së implementuari.

Arsyet për nivelin e ulët të zbatimit të këtyre objektivave ndërlidhen me mungesën e buxhetit, mungesën e mbështetjes dhe mungesën e kapaciteteve të komunës për realizimin e këtyre objektivave. Për më shumë detaje referojuni tabelës: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM 2016-2021.

Tabela 9: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM 2016-2021

Objektiva	Objektiva e MM	Treguesi i performances	Gjendja fillestare	Caku	Realizimi	Koment
OB1	Krijimi i infrastrukturës komunale për menaxhimin e mbeturinave - Formimi dhe fuqizimi i sektorit për menaxhimin e mbeturinave	Deri në vitin 2017, të themelohet dhe fuqizohet Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave	Komuna nuk ka sektor për menaxhimin e mbeturinave	Te formohet dhe te funksionalizohet sektori për menaxhimin e mbeturinave	Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave është paraparë në organogramin e komunës	
OB2	Përgatitja e rregullores së brendshme të funksionimit për ndërmarrjen e cila merret me pastrimin gjelbërimit sipas zonave, në mënyrë të veçantë për shërbimin e pastrimit ku të përcaktohen detyrat dhe të drejtat e personelit.	Rregullorja e brendshme për funksionimin e ndërmarrjes e aprovuar, detyrat dhe të drejtat e personelit te percaktuara	Komuna nuk ka pasur rregullore te brendshme për funksionimin e ndërmarrjes e cila merret me pastrimin dhe gjelbërimit sipas zonave dhe percakton detyrat e personelit	Te përgatitet dhe aprovet rregullorja e brendshme për funksionimin e ndërmarrjes e cila merret me pastrimin gjelbërimit sipas zonave dhe te përcaktohen detyrat dhe të drejtat e personelit.		
OB3	Reduktimi gradual i mbeturinave të rrezikshme përmes përdorimit të kapaciteteve ekzistuese industriale për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme	Sasia e mbeturinave te rrezikshme te trajtuara përmes përdorimit të kapaciteteve ekzistuese industrial	Disa deponi me mbeturina te rrezikshme te evidentuara	Mbeturinave te rrezikshme te eliminuara përmes përdorimit të kapaciteteve ekzistuese industrial		
OB4	Eliminimi i deponive ilegale/të egra dhe Shndërrimi i deponive ilegale në hapësira gjelbëruese	Shendrrimin e deponive ne hapsira te gjelberuese	Verifikimin e dponive ilegale nëpër hapsira publike	Eliminimi i deponive ilegale/të egra dhe Shndërrimi i deponive ilegale në hapësira gjelbëruese	Deponitë elimonohen në baze vjetore por krijohen deponi te reja (Kënaqshëm)	
OB5	Ofrimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave permes themelimit te ndërmarrjes publike lokale ose permes operatorët privat	Deri në vitin 2021, të themelohet Ndërmarrja Publike Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave (NPKMM).	Kryerja e shërbimit nga kompania KRM “Pastërtia” në periudhën tranzitore	Themelimi ndër- marrjes publike lokale ose Licencimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga operatorët privat.	Është bërë decentralizimi financiarë i KRM Pastërtia njësia Kaçanik (Knaqshëm)	
OB6	Fillimi i ndarjes së mbeturinave dhe riciklimi	Ndarja në burim dhe riciklimi	Mbledhja e mbeturinave pa ndarje në burimi dhe pa riciklim	Të fillon ndarja e mbeturinave ne burim duke filluar edhe riciklimin e tyre.	Nuk ka filluar ndarja e mbeturinave dhe riciklimi (Dobët)	
OB7	Përcaktimi i tarifës dhe rritja e	Percaktimin e tarifës	Mënyra e inkasimit	Ikasimi i mjeteve sipas	Tarifat janë përcaktuar dhe	

	inkasimit për grumbullimin e mbeturinave.	nëpërmes rregullore per menaxhimin e mbeturinave		rregullore per menaxhimin e mbeturinave dhe procesit tarifar	inkasimi është realizuar (Kënaqshëm)	
OB8	Rritja graduale e përfshirjes së popullsisë në sistemin trajtimit të mbeturinave përmes insentivave nxitese	Rritja e nivelit të trajtimit të mbeturinave përmes insentivave nxitese	Komuna nuk ka insentivave nxitese për trajtimin e mbeturinave	Insentivat nxitese për trajtimin e mbeturinave të zbatuara	Aktualisht ofrohet vetëm sistemi i grumbullimit të mbeturinave në 26 vendbanime nga 31 ose në 80% të EF. Nuk ka filluar së zbatuari sistemi i trajtimit të mbeturinave (Kënaqshëm)	
OB9	Ndërtimi (percaktimi i lokacionit) i deponisë për mbetje ndërtimore	Deponimi i mbetjeve të ndërtimit dhe demolimit	Komuna nuk ka lokacion dhe deponi për mbetje ndërtimore	Deponia për mbetje ndërtimore e funksionalizuar		
OB10	Krijimi i bazës së të dhënave qendrore dhe informacionit mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave.	Gjenerimi i të dhënave dhe informacionit mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave	Komuna nuk ka pasur baze të të dhënave qendrore dhe informacione mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave.	Baze të të dhënave qendrore dhe informacione mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave e funksionalizuar		
OB11	Te sigurojë blerjen e kontejnerëve metalike të mbeturinave me kapacitet 1.1 m ³ për t'i shpërndarë në territorin e komunës	Deri më 2018, të shpërndahen 3.000 copë shporta 120 l. Deri më 2018, të shpërndahen 300 copë kontejner 1,1 m ³ .	Klientet kanë pas kontejner të vjetër 120L dhe 1.1m ³ dhe jo në gjendje të mirë funksionale	Të gjithë ekonomit familjare, institucionet, bizneset të furnizohen me kontejner të ri dhe funksional	Janë shpërndarë 3823 copë shporta 120 l. Janë shpërndarë 119 copë kontejner 1,1 m ³ . (Kënaqshëm)	
OB12	Të sigurojë blerjen e makinerisë së nevojshme për mbledhjen e mbeturinave.	Deri më 2021, komuna të pajiset me dy kamionë.	KRM "Pastertia" nuk ka makineri të mjeftueshme për mbledhjen e mbeturinave	KRM "Pastertia" e furnizuar me makineri për mbledhjen e mbeturinave	E realizuar 100%	Janë siguruar tre (3) automjete të përdorura dhe katër (4) kamionë të rinj
OB13	Kompletimi i rregulloreve komunale për menaxhimin e mbeturinave në bazë të ligjit	Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave e miratuar nga kuvendi i komunës	Veprimet e marra duke u bazuar në rregulloren për menaxhimin e mbeturinave	Zbatimi i rregullore Menaxhimin e mbeturinave	E realizuar 100%	Është miratuar rregullorja komunale për menaxhimin e mbeturinave në bazë të ligjit

OB14	Reduktimin gradual të mbeturinave në burim para deponimit dhe ripërdorimi i mbeturinave.	Ndarja në burim dhe ripërdorimi i mbeturinave	Mbledhja e mbeturinave pa ndarje në burimi	Të fillon ndarja e mbeturinave në burim duke filluar edhe ripërdorimi i tyre.	Nuk ka filluar se zbatuari (Dobët)	Nuk ka filluar ndarja e mbeturinave dhe reciklimi
------	--	---	--	---	------------------------------------	---

1.8. Performanca e shërbimit

Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve:

Stafi i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Kaçanikut, përbehet nga 38 veta dhe përfshin stafin direkt të angazhuar në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të cilët i mbështesin ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Në kuadër të stafit direkt përfshihen 21 veta, 20 nga të cilët janë punëtorë. Ndërsa në kuadër të stafit indirekt dhe administrativ janë 17 veta.

Nëse analizojmë efikasitetin e stafit të angazhuar në menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Kaçanikut, efikasiteti për kg mbeturina të grumbulluara është 56.8 kg/kokë stafi, ndërsa për ekonomi familjare është 59.9 ekonomi familjare/ kokë stafi për kokë stafi.

Më shumë detaje janë prezantuar në tabelën 10 ku është prezantuar efikasiteti i stafit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Kaçanikut.

Tabela 10: Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM	
Kategoria	Numri i stafit
Stafi direkt	Operativ
Kryepunëtorë	1
Shoferë	6
Punëtorë	14
Total staf direkt:	21
Staf indirekt dhe administrative	Administrativ
Drejtorët e bordit	1
Menaxhmenti i lartë ⁴	2
Zyrtarë të rangut të mesëm	7
Staf teknik	6
Zyrtarë të rangut fillestar	-
Staf tjetër	-
Total staf indirekt dhe administrative:	17
Total staf të MM	38
Mbeturina të grumbulluara	4205000 kg
Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara	56.8 kg /per koke stafi
EF të shërbyera	4445
Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera	17.9

⁴ KE, ZKF, drejtorët e departamenteve, dhe pozita tjera të larta.

Performanca e asetëve të grumbullimit dhe transportit:

Performanca e paisjeve të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave është e prezantuar në tabelën 11. Duke ju referuar të dhënave në tabelë, konstatojmë se komuna ka në dispozicion 12 kamionë me kapacitet 63 ton. Mjetet transportuese përkatësisht kamionët shpenzojnë 284414 litra naftë/vit. Konsumi i naftës për ton/mbeturina të grumbulluara është 67.6 litër.

Tabela 11: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	
Kategoria	Performanca
Kamionët në operim	8
Kapaciteti maksimal operues	63 ton
Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit)	4205
Konsumi i naftës (l/vit)	284414
Efikasiteti i Shfrytëzimit %	
Konsumi i naftës l/100 km	67.6 litra/ton mbeturina

1.9. Performanca financiare e MM

1.9.1. Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të dhënat e prezantuara në tabelën 13 i referohen të hyrave dhe arkëtimit nga shërbimet operative primare dhe sekondare për menaxhimin e mbeturinave. Sikurse është prezantuar edhe në tabelë shuma e faturave të lëshuar në euro për vitin 2021 ka qenë 296,559.60, ndërsa të hyrat e realizuara ishin 268,197.20.

Tabela 13: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM		
	Të hyrat	Arkëtimi
Të hyrat operative	Nr i faturave të lëshuara/shuma në Euro	Nr i faturave të arkëtuara/shuma në Euro
Amvisëritë	239,004.24	208,363.03
Bizneset	33,577.56	35,856.37
Institucionet	23,977.80	23,977.80
Nga shërbimet tjera të kontraktuara	N/A	N/A
Total:	296,559.60	268,197.20

1.9.2. Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Të hyrat nga arkëtimi janë 296,559.60 Euro. Shkalla e mbulimit nga faturimi është 100%, shkalla e mbulimit nga arkëtimi është 90.72% (tabela 14).

Tabela 14: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit	
Arkëtimi	268,197.20
Shkalla e mbulimit nga faturim %	100%
Shkalla e mbulimit nga arkëtimi %	90.72 %

1.10. Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

1.10.1. Qendrat e transferit dhe të riciklimit

Në komunën e Kaçanikut operojnë dy operatorë për menaxhimin e mbeturinave KRM – "Pastërtia" dhe NP "Krasniqi". Mbeturinat të cilat i menaxhon kjo ndërmarrje, janë kryesisht mbeturinat e amvisërisë (komunale), mbeturinat nga mishtoret (therrtoret) dhe mbeturina të ngurta (beton, tulla, tjegulla dhe mbeturina nga orëditë e vjetruara shtëpiake).

Kaçaniku nuk ka stacion të transferit në territorin e tij, por ka të drejtë ligjore që ta përdorë stacionin e transferimit të mbeturinave në Ferizaj. Kapaciteti i përgjithshëm i këtij stacioni është 50,000 m³, ose 2,500 ton/muaj. Mbeturinat që dërgohen në stacionin e transferit në Ferizaj nuk riciklohen. Në territorin e komunës së Kaçanikut nuk ka ndonjë formë tjetër të organizuar të grumbullimit të mbeturinave nga qytetarët apo klientët tanë.

1.10.2. Deponimi

Në territorin e komunës së Kaçanikut, nuk ka deponi sanitare të mbeturinave. Operatorët për menaxhimin e mbeturinave KRM – "Pastërtia" dhe NP "Krasniqi", sipas nevojës për deponimin e mbeturinave shfrytëzojnë Deponinë Sanitare të Mbeturinave në Velekincë të Gjilanit apo Deponinë Sanitare në Mirash të Obiliqit, që menaxhohen nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë – KMDK.

1.10.3. Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim-demolimi- Menaxhimi i mbeturinave të këtyre dy kategorive deri më tash është bërë sipas kërkesës nga klientët (Ekonomitë familjare, bizneset, etj.) Në momentet kur gjeneruesit kanë krijuar këto lloje të mbeturinave, kanë kërkuar nga operatori i grumbullimit të mbeturinave dhe më pas operatori ka grumbulluar ato. Këto mbeturina të grumbulluara më pas janë ndarë në fraksione dhe janë përdorur për nevoja të ndryshme (si për shëmbull janë shitur, janë djegur, etj.)

Për menaxhimin e mbeturinave shtazore, medicinale dhe kategorive tjera të mbeturinave nuk ofrohet ndonjë praktikë standarde e menaxhimit të tyre. Kjo për shkak se komuna nuk ka gjenerim të madh të këtyre llojeve të mbeturinave dhe rrjedhimisht nuk ka procedurë standarde. Mbeturinat medicinale kryesisht menaxhohen nga ministria, kurse për të tjerat kategori nuk ka gjenerim të madh.

2. Objektivat e MM dhe plani operacional

2.1. Vizioni i MM

“Kaçaniku, një komunë e cila promovon menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave, të bazuar në parimet e ekonomisë qarkore, me synim mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e resurseve natyrore dhe zhvillimit ekonomik lokal”

Komuna e Kaçanikut synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar me qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth zvogëlim, ripërdorim dhe riciklim, komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat, institucionet, dhe bizneset), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave. dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

2.2. Objektivat dhe caqet e MM

PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 15: Lista e objektivave të planit	
Numri objektivit	Emërtimi
Objektivi 1	Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave
Objektivi 2	Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
Objektivi 3	Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
Objektivi 4	Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave
Objektivi 5	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

2.2.1. Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Komuna e Kaçanikut, është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioritetëve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

Tabela 16: Korniza strategjike e Objektivit 1

Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /pcp /ditë)	Sasia e mbeturinave (kg /pkb/ditë)	0.47	0.49	0.50	0.52	0.54	0.56
Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e mbeturinave të grumbulluara	Shërbimi është riorganizuar që të mundësoj matjen	-	-	1	-	-	-
Zbatimi i tarifave volumetrike	Tarifat janë miratuar dhe po aplikohen	-	-	-	1	-	-
Futja e pakos stimuluese	Pakoja stimuluese është hartuar dhe miratuar	-	-	-	1	-	-
Shpërndarja e komposterëve individual	Numri i komposterëve të shpërndarë	-	167	50	50	20	20
Zbatimi i fushatës informative	Fushata informative zbatohet	-	1	1	1	1	1

2.2.2. Masat dhe aktivitetet për parandalimin dhe reduktimin e mbeturinave

Në vijim janë prezantuar masat dhe aktivitetet për arritjen e kësaj objekte:

- Zbatimi i tarifave vëllimore PAYT ku konsumatori faturohet në bazë të mbeturinave të hudhura (ngajshëm me shërbimin e rrymës dhe ujit)
- Facilitimi i hapjes së dyqaneve pa paketim dhe rimbushëse
- Facilitimi i hapjes së restauranteve dhe hoteleve “zero ëaste”
- Futja e stimujve të përshtatshëm fiskal, tarifave preferenciale, kontraktimi dhe prokurimi publik preferencial nga këto subjekte
- Në koordinim, me nivelin qendror të bëhet ndalimi i qeseve plastike dhe paketimit njëpërdorimësh
- Kompostimi individual
- Fushatat vetëdijësuese për parandalim dhe reduktim të mbeturinave.

Komuna, në bazë të specifikave të veta do t'i përshtasë masat të cilat do ti ndërmarrë për realizimin e kësaj objekte.

Disa masa varen nga niveli qendrorë, si ndalimi i qeseve plastike dhe ambalazhit. Në këto raste komuna do të përcjellë zhvillimet nga niveli qendrorë dhe t'i zbatoj përbrenda territorit të komunës.

2.2.3. Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objektivi ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veçantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Edhe pse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizojë skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Tabela në vijim jep kornizën strategjike për objektivin 2, së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

Tabela 17: Korniza strategjike e Objektivit 2							
Masat / aktivitet / treguesi i performancës	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit	Studimi i fizibilitetit është zbatuar			1			
Zgjerimi i infrastrukturës ndarëse të mbeturinave në burim	% EF me ndarje në burim	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Riciklimi i letrës	% e riciklimit të letrës dhe kartonit	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Riciklimi i plastikës	% e riciklimit të plastikës	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Riciklimi i metalit	% e riciklimit të metalit	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Riciklimi i qelqit	% e riciklimit të qelqit	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Studim i fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale të riciklueshme dhe biodegraduese	Studimi i fizibilitetit është zbatuar	-	-	-	-	-	-
Funksionalizimi i qendrës së grumbullimit dhe riciklimit	Qendra e grumbullimit është funksionalizuar dhe futur në operim	-	-	-	1	-	-
Caktimi i lokacionit të deponisë së MND	Lokacioni i deponisë të MND është përcaktuar	-	1	-	-	-	-
Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të grumbullimit, transportimit dhe riciklimit të MND në komunë.	Studimi i fizibilitetit është zbatuar	-	-	1	-	-	-
Kontraktimi i operatorit privat për MND	Operatori është kontraktuar	-	-	1	-	-	-
Kontraktimi i operatorit privat për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të riciklueshme jo degraduese	Operatori është kontraktuar	-	-	1	-	-	-

Kontraktimi i operatorit privat për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio degraduese	Operatori është kontraktuar	-	-	1	-	-	-
--	-----------------------------	---	---	---	---	---	---

Analiza e potencialit të gjenerimit, kompozicionit dhe riciklimit të mbeturinave

Analiza në fjalë nisët nga parashikimet demografike të popullatës.

Tabela 18: Parashikimet demografike të popullatës						
Vendbanimi	Numri i popullatës					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Qyteti (rritje / zbritje)	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje
Qyteti (banorë)	10,512	10,690	10,871	11,055	11,242	11,433
Zona ruarë (rritje / zbritje)	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje
Zona ruarë (banorë)	23, 976	24,892	25,315	25,746	26,184	26,629
Total banorë	34,988	35,582	36,186	36,801	37,426	38,062

Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave, është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit të mbeturinave, që është marrë nga studimi për regjion të Ferizajt, në mungesë të një hulumtimi për komunën e Kaçanikut.

Tabela 19: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Popullata në zonën urbane	10,512	10,690	10,871	11,055	11,242	11,433
Gjenerimi për kokë banori ZU kg/vit	171	171	171	171	171	171
Gjenerimi i mbeturinave ZU ton/vit	17,975	18,279	18,589	18,904	19,223	19,441
Popullata në zonën rurale	23, 976	24,892	25,315	25,746	26,184	26,629
Gjenerimi për kokë banori ZR kg/vit	171	171	171	171	171	171
Gjenerimi i mbeturinave ZR ton/vit	40,998	42,565	43,288	44,025	44,774	45,535
Popullata në komune (total)	34,988	35,582	36,186	36,801	37,426	38,062
Gjenerimi vjetorë i mbeturinave ton/vit	58,973	60,844	61,887	62,929	63,997	64,976

Parashikimi i kompozicionit të mbeturinave të gjeneruara është dhënë në tabelat në vijim, i bazuar në studimin e kompozicionit nga regjioni i Ferizajt, meqenëse në komunën e Kaçanikut nuk ka pasur ndonjë hulumtim për kompozicionin e mbeturinave.

Tabela 20: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit						
	Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
%	Letër dhe karton	21.5	21.5	21.5	22	22
	Qelq	3.5	3.5	3.5	3.5	3.5
	Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	34.1	34.1	34.1	34	34
	Tekstil dhe veshjet	7.4	7.4	7.4	7.5	7.5
	Pllastika	20.9	20.9	20.9	21	21
	Metal	1.8	1.8	1.8	2	2
	Të tjera	10.8	10.8	10.8	10	10
Ton	Letër dhe karton	13,081	13,305	13,530	14,079	14,318
	Qelq	2,129	2,166	2,203	2,268	2,307
	Mbeturina bio-degraduese ⁵	20,747	21,101	21,459	21,824	22,195
	Tekstil dhe veshjet	4,502	4,579	4,656	4,735	4,815
	Pllastika	12,777	12,994	13,215	13,440	13,668
	Metal	1,095	1,114	1,133	1,153	1,173
	Të tjera	6,571	6,683	6,797	6,913	7,031

Në tabelën në vijim janë dhënë caqet preliminare të komunës, karshi ripërdorimit / riciklimit të fraksioneve të caktuara të mbeturinave komunale si letra, plastika, qelqi dhe metali.

Megjithatë për caqe më të sakta të ripërdorimit dhe riciklimit, komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të riciklimit të mbeturinave në komunë**.

Në tabelën në vijim janë vendosur caqet preliminare të riciklimit në % .

Tabela 21: Analiza e potencialit të mbeturinave që mundën të ricikohen						
	Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
%	Letër dhe karton	5%	10%	20%	30%	40%
	Qelq	5%	10%	20%	30%	40%
	Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	5%	10%	20%	30%	40%
	Tekstil dhe veshjet	5%	10%	20%	30%	40%
	Pllastika	5%	10%	20%	30%	40%
	Metal	5%	10%	20%	30%	40%
	Të tjera	5%	10%	20%	30%	40%
Ton	Letër dhe karton	654	1330	2706	4223	5727
	Qelq	106	216	440	680	922
	Mbeturina bio-degraduese ⁶	1037	2110	4292	6547	8878
	Tekstil dhe veshjet	225	458	931	1420	1926
	Pllastika	638	1299	2643	4032	5467
	Metal	54	111	226	346	469
	Të tjera	328	668	1359	2074	2813

⁵ Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

⁶ Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

Avancimi i sistemit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave komunale:

- **Zgjerimi i infrastrukturës për ndarje në burim të mbeturinave komunale:**

Komuna e Kaçanikut, është e përkushtuar që të bëjë ndarjen në burim të mbeturinave komunale. Format e ndarjes varen nga faktorë të ndryshëm, dhe mund të marrin forma sa vijon:

- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim derë më derë;
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim derë më derë;
- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët;
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët;
- Ndarja në mbi tre fraksione „letër – qelq – plastikë - metal, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët.

Forma e ndarjes kushtëzohet nga tipi i vendbanimit (rezidencial dhe banim kolektiv), kapaciteti buxhetorë, infrastruktura ricikluese e të ngjashme.

Megjithatë tipi i ndarjes së mbeturinave do të përcaktohet nga **plani i riorganizimit të shërbimit** që do ta zhvillojë komuna (tek objektiva 3).

Në tabelën në vijim do të jepet orari i shtrirjes së ndarjes së mbeturinave në burim për komunën e Kaçanikut:

Tabela 22: Orari i ndarjes së mbeturinave në burim						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi total me shërbim	80 %	85%	90%	95%	100%	100%
Mbulimi me ndarje në burim	5%	10%	15%	25%	35%	45%

- **Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme:**

Komuna e Kaçanikut do të zbatojë një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, i cili përfshinë si fraksion të ndarë mbeturinat e riciklueshme jo-biodegraduese⁷**. Studimi do të bazohet në analizën e kompozicionit, tregun e të riciklueshmeve dhe sektorin e ricikluesve privat dhe poashtu do të marr parasysh kërkesat ligjore dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbeturinave si dhe praktikën më të mira.

Sipas strategjisë së mbeturinave 2021 – 2030 parashihet të zbatohet skema e sistemit të kthimit të depozitës për ambalazhet e pijeve tek prodhuesit dhe tregëtarët e pijeve që

⁷ Letra, plastika, metali, tekstili ,etj.

paraqet një përqindje të konsiderueshme të këtyre mbeturinave. Poashtu strategjia e mbeturinave parasheh, operimin e qendrave të riciklimit ku do të dërgohen këto mbeturina.

Megjithatë deri sa të zbatohet skema e kthimit të depozitës dhe funksionalizohet qendra e riciklimit, komuna do të synoj të bëjë partneritet me ricikluesit privat për të bërë grumbullimin dhe transportin e të riciklueshmeve jo-biodegraduese.

Pra, komuna sa i përket mbeturinave të riciklueshme jobiodegradues do të zbatojë:

- studimin e fizibilitetit të zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave të riciklueshme të padegradueshme
 - zhvillimin e partneritet me ricikluesit privat për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave
- **Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale biodegraduese:**

Ngjashëm si me mbeturinat e riciklueshme jo të degradueshme, komuna do të zbatojë një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, i cili përfshinë si fraksion të ndarë mbeturinat biodegraduese**. Mbeturinat që do të përfshihen në këtë fraksion, do të jenë mbeturinat nga ushqimet, vajrat e përdorura ushqimore, dhe mbeturinat nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike.

Sipas strategjisë, secili rajon do të ketë një qendër të kompostimit të centralizuar, ku do të dërgohen **mbeturinat biodegraduese ushqimore**. Por deri sa të ndërtohet dhe funksionalizohet kjo qendër komuna do të konsideroj zhvillimin e skemës lokale të kompostimit përmes angazhimit të operatorëve privat të interesuar që të grumbullojnë dhe transportojnë këto mbeturina.

Komuna do të ndërtoj skemën lokale të kompostimit për **mbeturinat biodegraduese nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike** të cilat për shkak të specifikave të tyre, duhet të kompostohen lokalisht meqë transportimi i tyre është i kushtueshëm dhe joefikas.

Sa i përket **vajrave të përdorura ushqimore**, komuna do tju kërkojë objekteve gastronomike që i prodhojnë këto vajëra me shumicë, të lidhin kontrata valide me operatorët të licencuar të vajërave ushqimore nga MESPI të cilët do të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre vajrave. Komuna do të organizoj mbikëqyrjen dhe inspektimin e mbarëvajtjes së kësaj skeme të organizimit dhe do të shqiptoj dënime në rast të shkeljeve.

Pra komuna sa i përket mbeturinave biodegraduese do të zbatojë:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale biodegraduese;
- zhvillimin e skemës lokale të kompostimit në partneritet me ricikluesit privat
- inspektimin e lokaleve gastronomike sa i përket zbatimit të kontratës për vajra mbeturinë.

Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale:

- **Hapja e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit:**

Komuna e Kaçanikut planifikon të hapë, **1 qendër për grumbullimin dhe ripërdorimin e mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale**. Për hapjen e këtyre qendrave komuna **do ta caktojë lokacionin**.

Në këtë objekt qytetarët do të dërgojnë artikujt e padëshiruar të tyre sa vijon:

- Mobilje dhe orendi
- Tekstil dhe veshëmbathje
- Pajisje shtëpiake dhe mbeturina tjera të vëllimshme

Përpos këtyre artikujve të padëshiruar qytetarët do të dorëzojnë edhe gomat, bateritë, vajrat mbeturinë dhe mbeturina tjera.

Komuna do të zbatojë një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit** të qendrës (qendrave) përmes së cilit do të analizohet dhe do të vendoset se a do ta menaxhoj vetë këtë qendër komuna apo ta angazhoj një operator privat.

Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi:

Sa i përket MND ligji parasheh caktimin e lokacionit të deponisë që është një zgjidhje e përkohshme dhe ndërtimin dhe funksionalizimin e qendrës së grumbullimit dhe riciklimit të këtyre mbeturinave e cila sipas strategjisë së mbeturinave do të organizohet në formë rajonale.

Komuna sipas ligjit e kontraktos shërbimin me operator të licencuar, cakton tarifat e shërbimit dhe se ndërtuesit kanë të drejtë që ti ndajnë dhe riciklojnë mbeturinat e tyre në kantierin e punimit si dhe ti transportojnë mbeturinat deri te destinacioni i autorizuar.

Komuna jonë, ende nuk e ka caktuar lokacionin e deponisë por do ta planifikoj këtë gjë në këtë plan. Komuna do ti dërgoj mbeturinat në këtë lokacion i cili do të operohet nga kontraktori i licencuar i cili poashtu do të kontraktohet nga komuna siq e parasheh ligji.

Komuna do të instaloj një sistem i cili në kuadër të Lejes Ndërtimore, do të kërkojë që ndërtuesi të ketë edhe një plan të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet sasia e mbeturinave që do të deponohen dhe lokacioni ku do të dërgohen ato. Poashtu, inspeksioni do të mbikëqyrë zbatimin e këtij plani dhe të parandaloj hudhjen e këtyre mbeturinave në vende të papërshtatshme.

Në momentin e funksionalizimit të qendrës rajonale komuna do ti dërgoj mbeturinat tek kjo qendër. Poashtu tarifat do të caktohen në nivel të komunave të cilat do të shërbejnë nga kjo qendër e grumbullimit dhe riciklimit të MND.

Megjithatë komuna për territorin e saj do të zbatojë një **studim fizibiliteti të modelit të operimit të grumbullimit dhe transportit të MND si dhe të riciklimit të tyre nga ndërtuesit**.

Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor:

Komuna, respektivisht Drejtoria për Shëndetësi, por edhe Njësia e Inspektoriatit, do të monitoroj menaxhimin e mbeturinave spitalore sipas legjislacionit në fuqi.

Inpektori komunal i mjedisit, do të bëjë mbikqyrje inspektive mbi menaxhimin e mbeturinave edhe atyre medicinale në këtë rast, bazuar në Nenin 62, 63, 65, dhe 66 të Ligjit për Mbeturina.

Komuna - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të sigurojë dhe vendosë kontejnerë për hedhjen e barnave të papërdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publike dhe private, gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetësorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në kontejnerë, enë apo thasë përkatëse të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.

Operatorët publik dhe privat, si prodhues të mëdhenjë të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.

Nëse institucionet shëndetësore nuk i trajtojnë vet mbeturinat spitalore që i krijojnë, atëherë duhet të kenë kontratë me operatorët e licencuar për trajtimin e këtyre mbeturinave. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të kontrollojë nëse këto kontrata janë të lidhura dhe po zbatohen.

Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave shtazore nga thertoret:

Sipas strategjisë së mbeturinave, mbeturinat shtazore nga thertoret do të dërgohen tek qendra e grumbullimit dhe riciklimit në zonën industriale në Drenas të ndërtuar nga BE. Megjithatë kjo qendër ende nuk po funksionalizohet që po na e pamundëson organizimin e kësaj skeme.

Komuna do të organizojë këtë shërbim, për fazën tranzitore deri në funksionalizim të qendrës duke i dërguar këto mbeturina nga operatori i grumbullimit të mbeturinave për të bërë varrimin e tyre të gëlqerosur dhe njëkohësisht do të shikojë mundësinë e angazhimit të operatorëve privat të licencuar nga AVUK që të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre mbeturinave tek impijantet e tyre.

Mishtoret, thertoret dhe industritë përpunuese të mishit duhet të sigurojnë kontejnerë hermetik të ndarë ku do ti hudhin mbeturinat shtazore deri në momentin e grumbullimit dhe të kenë kontrata valide me operatorin,

të cilat do të inspektohen nga komuna në mënyrë periodike.

Aktivitet vetëdijësuese për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave:

Komuna do të organizojë fushata informative të komunikimit me publikun sa i përket ndarjes, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, dhe kategorive tjera.

Informimi do të sqarojë se si duhet të hudhen mbeturinat në kontejnerë / shporta të ndara, për dërgimin e mbeturinave në qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit, dhe të ngjajshme. Fushata do të organizohet që të targetojë institucionet shkollore për të ngritur nivelin e edukimit mjedisorë.

2.2.4. Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM

Objektivi 3, ka të bëjë me komponentën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale. Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qëndrueshmërisë financiare dhe të kostos.

Tabela 23: Korniza strategjike e objektivit 3							
Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit	% e popullatës së shërbyer	80%	82%	85%	90%	95%	100%
Plani i ri operativ do të hartohet (revidohet)	Plani operativ është hartuar (reviduar)	-	1	-	-	-	-
Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna	Komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin	-	-	1	-	-	-
Zgjidhja e statusit të rasteve sociale	Pagesa e faturave për rastet sociale është zgjidhur	-	-	1	-	-	-

Në vijim jepen masat dhe aktivitetet kyçe të objektivës 3:

Zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Tabela në vijim jep orarin e zgjerimit të shërbimit. Komuna është e përkushtuar që të zgjerojë ofrimin e shërbimit në tërë territorin e saj. Strategjia e zgjerimit është që fillimisht të ofrohet shërbim i plotë në zonën urbane si dhe mbulimi me shërbim edhe për zonën rurale.

Tabela 24: Strategjia e zgjerimit me shërbim						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi me shërbim	80 %	85%	90%	95%	100%	100%

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Komuna do të komisionojë **planin e ri operativ**, i cili do të bëjë planin e riorganizimit të shërbimit i cili do të rezultojë përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes:

- Optimizimit të pikave të grumbullimit dhe frekuencës së ofrimit të shërbimit:

- Sigurimin e infrastrukturës adekuate për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale

Komuna do të **digjitalizoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave**, i cili do të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit. Ky sistem do të ofrojë informacionet për lëvizjet e kamionëve, informatat mbi lokacionin e kontejnerëve, nivelin e mbushjes dhe informatave tjera relevante, si dhe i njëjti do të integrohet me databazën e kujdesit të konsumatorëve.

Komuna do të ndërmerr **kampanjë informative**, për ti informuar qytetarët për mënyrën e re të grumbullimit të mbeturinave, përfshirë edhe mënyrën e hudhjes së mbeturinave, frekuencën e shërbimit e të ngjashme.

Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të kostos

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e efikasitetit operativ dhe të kostos, në funksion të përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare. Shtyllat kryesore të këtij plani janë optimizimi i efikasitetit të stafit dhe harxhimit të naftës.

Përmirësimi i efikasitetit të stafit

Komuna do të zbatoj aktivitetet sa vijon për ta përmirësuar efikasitetin e stafit të ofruesve publik të shërbimeve:

- Kontrollin (ngrirjen) e rekrutimit të stafit të ri administrativ dhe trajnimit të stafit ekzistues
- Zgjerimin e zonës së shërbimeve
- Diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së efikasitetit të stafit

Zyrtarët e MM dhe personat tjerë të përfshirë në planifikim, monitorim dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbajnë një kontroll strikt të numrit të stafit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 25: Efikasiteti i stafit						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Stafi direkt	37	-	-	-	-	-
Stafi indirekt dhe administrativ	37	-	-	-	-	-
Amvisëritë (EF) e shërbyera	3847	-	-	-	-	-
Efikasiteti i stafit për 1000 konsumatorë të shërbyer	17.9	-	-	-	-	-

Përmirësimi i efikasitetit, kostos së grumbullimit dhe të harxhimit të naftës

Harxhimi i naftës është njëri ndër zërat më të lartë të kostove rrjedhëse të operatorëve të shërbimit, rreth 15% të kostove rrjedhëse në nivel të sektorit dhe kjo i atribuohet në masë të konsiderueshme joefikasitetit operativ por edhe keqmenaxhimit.

Masat / aktivitetet e propozuara përfshijnë:

- **Hartimi i planit të ri operativ** (riorganizimin e zonës dhe optimizimin e marshutave dhe frekuencës së grumbullimit)
- Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë të rinjë apo funksional (second-hand)
- Ndërtimin e transfer-stacionit për të shkurtuar distancën
- Përforcimin e kontrollit të brendshëm
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së harxhimit të naftës
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së kostos njësi të grumbullimit dhe transportit

Përmirësim i performancës financiare të ofrimit të shërbimit

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të ofrimit të shërbimeve. Masat kryesore të përmirësimit të qëndrueshmëris financiare janë:

- Kalimi i tarifave për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbi principet e mbulimit të kostos
- Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna
- Zgjidhja e pagesës së faturave për rastet sociale

2.2.5. Objektivi nr. 4: Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit

Objektivi 4, ka të bëjë me komponentën e deponimit të sigurt të mbeturinave, dhe synimi kryesorë i këtij objekti është eliminimi i deponive ilegale dhe parandalimi i krijimit të deponive të reja ilegale. Përmes këtij objekti komuna do të fokusohet në rehabilitimin e deponive për të arritur standardet mjedisore.

Tabela 26: Korniza strategjike e objektivit 4

Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Caktimi i tarifave të shërbimit të deponimit	Tarifat janë caktuar	1	-	-	-	-	-
Rehabilitimi i deponisë ilegale të mbeturinave	Numri i deponive ilegale	18	15	13	10	5	0

2.2.6. Objektivi 5: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Objektivi 5, ka të bëjë me komponentën e zhvillimit të kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave. Ky objektiv synon fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe zhvillimin e kuadrit për menaxhimin efikas të mbeturinave.

Tabela 27: Korniza strategjike e objektivit 5

Aktiviteti / Masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Revidimi i RrK të MM	RrK e MM është reviduar	-	-	1	-	-	-
Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	Zyrtari i MM është emëruar/Spektori është formuar	1	-	-	-	-	-
Kalimi i procesit tarifarë	Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar	-	-	1	-	-	-
Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport	Operatori i licencuar është kontraktuar	-	-	1	-	-	-
Kontraktimi i operatorit për MND	Operatori i licencuar është kontraktuar	-	-	1	-	-	-

Emërimi i zyrtarëve komunal apo themelimi i njësitit për MM

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2020 me emërimin e zyrtarit komunal të MM.

Emërimi i inspektorit mjedisorë

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2020 me emërimin e inspektorit mjedisorë të MM.

Kalimi i procesit tariforë

Komuna e ka kaluar procesin tariforë në vitin 2019 dhe planifikon që ti nënshtrohet të njëjtit gjatë vitit 2023 për të reflektuar ndryshimin e kostove dhe parametrave tjerë relevant.

Zbatimi i programit të trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët

Ky program do të dizajnohet që të i ngris kapacitetet në zbatimin e proceseve si revidimi dhe zbatimi i PKMM, amendimi i RrK të MM, kalimin e procesit tariforë, draftimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe partneriteti publiko privat, zbatimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe skemës së kthimit të depozitës, ekonominë qarkore, riciklimin e mbeturinave e të ngjashme.

3. Plani i MM në kushte emergjente

Komunat duhet të bëjnë planifikimin e MM në kushte emergjente sipas kërkesave të Ligjit nr. 04/l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planit kombëtar të reagimit emergjent të Agjencisë për menaxhimin emergjent dhe ndonjë dokumenti tjetër relevant.

Fatkeqësitë sipas ligjit konsiderohen ngjarjet të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave. Në fatkeqësi përfshihen: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, shpërthim i sëmundjeve infektive aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, aksidentet ekologjike dhe industriale, lufta dhe gjendja emergjente, etj.

Ngjarja e fundit që ka kualifikuar për emergjencë apo fatkeqësi ka qenë pandemia Covid 19 dhe e cila na ka ofruar disa përvoja të dobishme.

Komuna do ta **mendoj planin komunal të reagimit emergjent duke shtuar kaptinën për menaxhimin e shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente!**

4. Plani financiar i veprimit dhe i monitorimit

Tabelat në vijim paraqesin në mënyrë tabelare planin financiar, te veprimit dhe monitorimit sipas objektivave përkatëse. Tabela prezanton objektivat dhe aktivitetet e planit, përgjegjësit për zbatimin e këtyre aktiviteteve, afatet kohore të implementimit, buxhetin e planifikuar, treguesit, vlerën bazë, caqet dhe realizimin. Këto tabela të vlerësimit dhe monitorimit do të shëbejnë edhe me rastin e revidimit të planit të ri, për të analizuar nivelin e zbatimit të planit paraprak sipas objektivave të parcaktuara.

Tabela 28: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 1 „Parandalimi dhe reduktimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Riorganizimi i shërbimit				30,000 €			30,000 €	
o Plani i riorganizimit të shërbimit	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
o Sigurimi i infrastrukturës matëse	DSHP			25,000 €			25,000 €	
Zbatimi i tarifave volumetrike			5,000 €				5,000 €	
o Kalimi i tarifave PAYT (procesi)	DSHP		1,500 €				1,500 €	Komuna
o Azhurnimi i softuerit të faturimit	DSHP		3,500 €				3,500 €	Komuna
o Zbatimi i tarifave PAYT	KRM			x				KRM
Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset				1,500 €			1,500 €	
o Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal	DF			1,500 €			1,500 €	Komuna
o Pakoja e lehtësimeve fiskale	DF			x				Komuna
Shpërndarja e komposterëve për EF dhe restorante			1,200 €	1,200 €	1,200 €	1,200 €	4,800 €	50% komuna; 50% donacion
Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e minimizimit		300 €	300 €	300 €	300 €	300 €	1,500 €	Komuna
o Fushata e vetëdijësimit	DSHP	300 €	300 €	300 €	300 €	300 €	1,500 €	Komuna
Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave		300 €	6,500 €	33,000 €	1,500 €	1,500 €	42,800 €	

Tabela 29: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave			2,500 €				2,500 €	Komuna
Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave komunale		5,000 €	5,000 €	50,000 €	5,000 €	5,000 €	70,000 €	
o Studim i fizibilitetit të ndarjes dhe operimit	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
o Zgjerimi i mbulimit të ndarjes në burim	DSHP	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	25,000 €	Komuna
o Kontraktimi i operatorit të riciklueshmeve	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
o Zhvillimi i skemës lokale të kompostimit	DSHP			35,000 €			35,000 €	Komuna
o Inspektimi i lokaleve gastronomike për vajëra	DSHP	X	X	x	x	x		

o Bashkimi i skemës ndërkomunale të kompostimit	DSHP							
Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale		5,000 €	25,000 €				30,000 €	
o Studimi i fizibilitetit	DSHP	5,000 €					5,000 €	Komuna
o Ndërtimi i qendrave të grumbullimit/ripërdorimit ⁸	DSHP		25,000 €				25,000 €	Donatori
o Funkcionalizimi i qendrave	DSHP							Komuna
Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi			5,500 €	75,000 €			80,500 €	
o Caktimi i lokacionit	DSHP	x						
o Kontraktimi i operatorit	DSHP		3,500 €				3,500 €	Komuna
o Caktimi i tarifave	DSHP		2,000 €				2,000 €	Komuna
o Rehabilitimi i qendrës së MND ⁹	DSHP			75,000 €			75,000 €	Donatori
o Bashkimi i skemës ndërkomunale të menaxhimit	DSHP					x		Komuna
Menaxhimi i mbeturinave shtazore								
o Lehtësimi i kontraktimit të operatorit privat	DSHP	x	X					
o Inspektimi i zbatimit	DSHP	x	X	x	x	x		
Menaxhimi i mbeturinave medicinale								
o Inspektimi i zbatimit	Inspektorati	x	X	x	x	x		Komuna
Fushatat e vetëdijësimit		1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	7,500 €	Komuna
Total objektiva 2 – Riciklimi dhe ripërdorimi		11,500 €	39,500 €	126,000 €	6,500 €	6,500 €	190,000 €	

Tabela 30: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“

Masat dhe aktivitetet	Njësiti përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		5,000 €	105,100 €	125,100 €	5,100 €	13,300 €	253,600 €	
o Përditësimi i planit operativ	DSHP	5,000 €					5,000 €	Komuna
o Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit				30,000 €			30,000 €	
o Furnizimi me shporta 120 l			1,800 €	1,800 €	1,800 €		5,400 €	30% Komuna;

⁸ Për komunën e Kaçanikut parashihet ndërtimi i një pike grumbulluese dhe një qendre të ripërdorimit. Buxheti përfshin infrastrukturën përcjellëse të qendrës si rrethoja, kamerat, bazamenti, kontejnerët, etj.

⁹ Fizibiliteti, rrethoja, makineria dhe pajisjet e nevojshme për menaxhimin e qendrës

								70% Donatori;
○ Furnizimi me shporta 240 l								30% Komuna; 70% Donatori;
○ Furnizimi me kontejnerë 1.1 m3			3,300 €	3,300 €	3,300 €	3,300 €	13,200 €	30% Komuna; 70% Donatori;
○ Furnizimi me kamionë dhe traktorë				80,000 €			80,000 €	Komuna; Donatori;
○ Ndertim i garazhes per kamiona te objekti i KRM Pastertia			100,000 €				100,000 €	Komuna
○ Paisje per magazinim te mbeturinave nga therretoret				10,000 €			10,000 €	Donatori
○ Impiant per pastrim automatik te shasisë se kamioneve						10,000 €	10,000 €	KRM
Përmirësimi i performancës operative dhe financiare			10,000 €				10,000 €	
○ Marrja përsipër e faturimit nga komuna				x				Komuna
○ Zhvillimi i softuerit të faturimit			10,000 €				10,000 €	Komuna
○ Zgjidhja e statusit të rasteve sociale		x	X	x	x	x		Komuna
○ Kalkulimi dhe monitorim i treguesit të stafit		x	X	x	x	x		Komuna
○ Kalkulimi dhe monitorim i treguesit të naftës		x	X	x	x	x		Komuna
○ Kalkulimi dhe monitorim i treguesit të arkëtimit		x	X	x	x	x		Komuna
○ Monitorim i treguesit të ankesave të klientëve		x	X	x	x	x		Komuna
Fushatat e informimit		x	X	x	x	x		
Total objektiva 3 - Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme		5,000 €	115,100 €	125,100 €	5,100 €	13,300 €	263,600 €	

Tabela 31: Plan i financiar, veprimet dhe monitorimit - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Caktimi i tarifave të shërbimit të deponimit	DSHP	5,000 €					5,000	Komuna
Eliminimi i deponive ilegale	DSHP	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	25,000 €	Komuna
Inspektimi dhe masat detyruese	Inspektorati	x	X	x	x	x	x	Komuna
Total objektiva 4 – Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit		10,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	30,000 €	

Tabela 32: Plani financiar, veprimet dhe monitorimit - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 – 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Revidimi i RrK të MM	DSHP		5,000 €				5,000 €	Komuna
Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	DSHP							Komuna
Kalimi i procesit tariforë	DSHP			3,500 €			3,500 €	Komuna
Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të MK	DSHP		25,000 €				25,000 €	Komuna
Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve	DSHP	7,000 €	7,000 €	7,500 €	7,500 €	7,500 €	35,000 €	Komuna
Hartimi i planit të menaxhimit të shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente si pjesë e planit të emergjencave të komunes.			3,000 €				3,000 €	
Total objektiva 5 – Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale		7,000 €	40,000 €	11,500 €	7,500 €	7,500 €	73,500 €	

